



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-29977 dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve privat Luan (Dervish) Dervishaj, “Gështënja Company” dhe Bekim (Sahit) Berisha, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, merr këtë:

VENDIM

Nr. 23/2025

**Mbi këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve privat me qëllim:
“Të formimit të rrugës” si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal**

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të formimit të rrugës si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr: 5506-5 në sipërfaqe prej 1074m² ZK Pejë do të merret me qëllim të formimit të rrugës si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me ngastrat kadastrale nr. 5755-109 me sipërfaqe prej 1122m² ZK Pejë dhe nr. 5753-4 në sipërfaqe prej 370m² pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme të aprovuara me datën 21.05.2025.

-Pronat e Komunës, dhe atë ngastra kadastrale nr. 5755-109 në sipërfaqe prej 1122m² ZK Pejë është vlerësuar me 80.00€/m² që në total i bie 89,760.00 €.

-Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr. 5753-4 në sipërfaqe prej 370m² ZK Pejë është vlerësuar me 80.00 €/m² që në total i bie 29,600.00€.

-Prona private e bashkëpronarëve Luan (Dervish) Dervishaj, “Gështënja Company” dhe Bekim (Sahit) Berisha me numër të ngastrës 5506-5 në sipërfaqe prej 1074m² ZK Pejë është vlerësuar me 80.00€/m² që në total i bie 85,920.00 €.

-Andaj obligohen bashkëpronarët privat Luan (Dervish) Dervishaj, “Gështënja Company” dhe Bekim (Sahit) Berisha që të paguajnë diferencën në shumën prej 33,440.00 € Komunës së Pejës bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ- së
Arkivës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj